



## Departamenti i Prokurimit

Prishtine date: 31.07.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 102-4 (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullues i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.07.2018, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Pastor Kosova SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Blerja e pajisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorre dhe ekstrakt – shkume për BPZ**", me Nr. të Prok: 616 18 009 121 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Pastor ShPK të dt 27.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Blerja e pajisjeve hidraulike për AKRR, gypa-zorre dhe ekstrakt – shkume për BPZ**" me Nr. 616 18 009 121 kundër Njoftimit për dhenie të Kontratës të AK –së, të datës 22.07.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 22.07.2018.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me Njoftimin për dhenie të kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.